



ZYRA E KRYETARIT

01-351-14791/24

30.04.2024

Bazuar ne nenin 81 te Ligjit e Prokurimit Publik nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe amandamentuar me LPP nr, 04/l-237 atë Nr. 05/L-068 dhe Nr.05/L-092 , mbi Aktivitetet e Menaxhimit te projektit dhe kontratës, ZKA , bie ketë :

## V E N D I M

Qe për Menaxhimin e kontratës nr. 39-2024 - te datës 30.04.2024 me numër te prokurimit 634-24-2688-5-2-1

Titull: Ndertimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Gllarevë-Rixhevë-Stapanicë- Zabergjë. Me Operatorin Ekonomik: REA SH.P.K Klinë me numër te ID 811242502

Për menaxhim te kontratës do te jete z. VISAR I. BOJAT nga Drejtoria e Urbanizmit derisa Menaxheri i projektit i njesise kerkuese, si bartës i aktiviteve te programit , dhe implementues i projektit Enver Berisha.

Plani për implementim i kontratës 12 muaj

Vlera e parashikuar e kontratës është 82.000.00 Euro

- Menaxheri i projektit ,si edhe përgjegjësi për menaxhimin e kontratës , do te bëje raport të punëve dhe përcjellje për pranim.
- Kryesuesi i aktivitetit te kontrates do te informoj ne gjithsecilën faze te aktiviteve zyrën e prokurimit, dhe pas perfundimit te kontrates sjelle ne Zyre te prokurimit raportin detal mbi aktivitetin e menagjimit te kontratës.
- Vendimi do te i dorzohet menagjerit te projektit së bashku me kontrate, ofertën financiare.
- Vendimit i bashkëngjiten : kontrata, sigurimi i ekzekutimit.

ZKA – KRYETARI  
z. ZENUN





## KOMUNA KLINE

Zyra e prokurimit

01 Nr 351-14791/24

DATE 30, 04, 2024

### KONTRATË NR. 39-2024

Numri i kontratës:<sup>1</sup> 634-24-2688-5-2-1/C749

**KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

"**REA**" SH.P.K., **ABEDIN REXHA, KLINË**, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

**Ndertimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Gllarevë-Rixhevë-Stapanicë- Zabergjë me numër identifikues: 634-24-2688-5-2-1**

#### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Ndertimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Gllarevë-Rixhevë-Stapanicë- Zabergjë**

No.	Lot
1	Ndertimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Gllarevë-Rixhevë-Stapanicë- Zabergjë

#### Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **82,000.00 €**; tetdhjet e dymijë Euro.

2.2 Plani dinaik është 12 muaj kalendarik.

2.3 sigurimi i ekzekutimit do të jetë 8,200.00 euro me validitet 12 muaj + 1 muaj= 13 muaj

2.4 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

2.5 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Ne baze te situacioneve mbi kryerje te punimeve me Raport nga Organi Mbikqyres dhe Fature

- Mbajtja e paras ne vlere 8,200.00 € do te paguhet pas Afatit te garancionit te punimeve mbas 12 muajeve pas pranimit te perkoheshem teknik . Kjo mund te paguhet me garancion nëse ekzistojn mjetet ne dispozicion )

### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

Sigurimi i ekzekutimit

Plani dinamik

Menaxheri i kontratës

Vertetimi ATK-se

Vertetimi i Gjykates

Arbk e biznesit

### **Neni 4 Komunikimet**


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe<sup>2</sup> në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Labinot Morina
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	30.04.2020
Vula:	



Për Kontraktuesin

Emri:	Piner Kasrati
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	30.04.2020
Vula:	



<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

ASFALTIMI I RRUGËVE : NË FSHATIN GLLAREVE RIXHEVE STAPANICE ZABERGJE

1. PARAMASA PËR ASFALTIMIN E RRUGËS SIPAS SITUACIONIT TË RRUGËVE TË SPECIFIKUAR NË PROJEKT (PJESA GRAFIKE)

Nr. rendit	Përshkrimi i postimeve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total në TVSH (€)
<b>1 PUNËT PARAFRAKTE</b>					
1.1	Mobilizimi i ndërmarrës për aktivitet, vendosja e shenjave për sigurim të komunikimit për aktivitet të punës në rrugë, në bashkëpunim me menaxherin e punës. Të dhënat L=1000.00 m <sup>2</sup> , b=2.83.0 m <sup>2</sup> ; Të dhënat L=250.00 m <sup>2</sup> , b=1.0 m <sup>2</sup> bashkë me 2x0.30m, kanal për ujërat atmosferik 1m në të dy anët ku ka lehtësia 1.1og m <sup>2</sup>	m	1250.00	5.00 €	6,250.00 €
1.2	Shërimi i tanës, si dhe përcjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit duke i trajtuar edhe elemente përcjellëse të rrugës si: Kryeja e rrugëve dytësore, interseptim (kryqëzime) në bazë të projektit zbatues, në mënyrë gjeodezike të përfshirë të gjitha punët e përmendura në kushtet e përgjithshme dhe teknike, log në m <sup>2</sup> Matjet gjeodezike në fund të projektit përfshihen të gjitha punët u kryera të sjellën hartat me kushtet e përgjithshme dhe teknike me gjendje të licencuar	m	1250.00	0.10 €	125.00 €
<b>Gjithsej: Post 1</b>					<b>6,375.00</b>
<b>2 PASTRIMI DHE DEMOLIMI TERENIT</b>					
2.1	Pastrimi i terrenit largimi i drumbëve, shkretëtirë dhe rrethujave me tela shembore dhe mbeturirat nga gërrat tresa të ngurta që u pengojnë gjatë ekzekutimit të rrugës. Pastrimi i tyre bëhet normal me drejtimin e rrugës me gjerësi të përcaktuar me projekt sipas profilit tërësor si dhe largimi i tyre në deponim në të afërta. Në këtë pozicion përfshihen edhe demolimi i rrethujave dhe këllimave në gjendje të meparshme pas përfundimit të punimeve. 1.1og në m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	1250.00	0.10 €	125.00 €
2.2	Disolokimi i infrastrukturës në afërsi të rrugës, instalimi, instalimet rrymë, instalimet telefonike dhe internetit, në trases e rrugës ku zhvillohen punimet e rrugës, zhvendosja e tyre jashtë rrugës në koordinatën me invitorimet përgjigjëse si KLEDS, PTT, ujësjellësi regional. Në rast të demitimit eventuel nga pakudenia O.E është i obliguar të afërta me të shkurtojë rikupërimin e kostos të vete bashkë me në mënyrë që vendosimet përveç rrugës e cila do të ndërtohet të mos mbështet në instalimet komunale. 1.1og në m <sup>2</sup> me të gjitha shprehjet	m <sup>2</sup>	1250.00	0.10 €	125.00 €
2.3	Pastrimi, zhbllkimi dhe mirëmbajtja e lehtësive ekzistuese sipër të akteve të rrugës në të dy anët e rrugës	m <sup>2</sup>	1250.00	0.10 €	125.00 €
<b>Gjithsej: Post 2</b>					<b>375.00</b>



3 PUNIMET TOKËSORE					
<p>Gërmimi dhe hapja e kanalit të kategorisë III-IV, deri në thellësinë dhe me gjerësi të nevojshme për punë të veçanta të gjatë pikat gjodetike dhe detaje sipas projektit të dizajnit në profilin gjatësor dhe tërthor.</p> <p>Në këtë pozicion përfshihen edhe hapja e kanaleve anësore, gërmimi dhe vendosja e lëshesave (kombinave) dhe elementeve tjera përcjellës të paracaktuar në projekt sipas kushteve teknike dhe përgatitshme, si dhe detajeve teknike. Në qmim përfshihen edhe ngjeshja me cilindër vrësor (pajisje vibruese) të pjesëve anësore dhe punimi i skarpave. Dheun i tepër bartet në depozitë me të afërta deri 5.0 km largësi.</p> <p>Vërejtje: Sigurimi nga shpëtimi duhet të bëjë punë kryesore, sipas detajeve teknike të përfshira në projekt.</p>					
3.1	Punimi me makineri (90%)	m <sup>3</sup>	1350.00	3.00 €	4,050.00 €
	Punimi me dorë (10%)	m <sup>3</sup>	150.00	2.00 €	300.00 €
Punimi i bazamentit (para mbushjes) me rrafshim dhe ngjeshje, si dhe rregullimi i pjerrtësisë tërthore dhe gjatësore të rrugëve sipas detajeve teknike të përfshira në projekt.					
3.2	Planifikimi dhe punimi i bazamentit të rrugës	m <sup>3</sup>	500.00	2.00 €	1,000.00 €
Mbushja e nivelizimit, ngjeshja (kompaktimi) i me cilindër vrësor me peshë 12t dhe me Mv=500kg/cm <sup>2</sup> në të gjitha pjesët e rrugës ku është bërë gërmimi.					
3.3	Platësimi, mbushja dhe nivelizimi i rrugës së rrugës me hartje të drejtë të zgjedhur deri në platësimin e kryesisë të rrugës sipas kushteve teknike të specifikuar në parashikimin teknik të projektit.	m <sup>3</sup>	500.00	2.30 €	1,150.00 €
Punimi i planimit dhe bankimit të rrugës dhe marrëveshje me hartje të materialit shpërndarë, rrafshim dhe ngjeshje me cilindër vrësor 18 ton sipas kushteve përgatitshme dhe teknike të specifikuar në projekt.					
3.4	Punimi i planimit dhe bankimit	m <sup>3</sup>	75.00	3.00 €	225.00 €
Gjithsej: Post 3					6,825.00
4 PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONJ)					
Punimi, transporti, shpërndarja dhe punimi i shtrësës së rrugëve me zhyrt nga guri të thyer fraksion 0-63 mm, me trashësi të shtrësës 1-20 cm të cilat i plotësojnë kushtet e parapara për tampion si dhe ngjeshja e tyre me cilindër vrësor deri sa të futeni moduli i ngjeshjes Mv=600 kg/cm <sup>2</sup> . Sigurimi. Pas përfundimit të kësaj shtrëse kompani punëkryese është obliguar të shpërndajë testin moduli të ngjeshjes dhe të prezantojë tek menaxheri kontratës.					
4.1	Furnizimi dhe punimi i shtrësës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-63 mm	m <sup>3</sup>	1000.00	12.35 €	12,350.00 €
Punimi, transporti, shpërndarja dhe punimi i shtrësës së rrugëve me zhyrt nga gurë të thyer fraksion 0-31.5 mm, me trashësi të shtrësës 1-10 cm, të cilat i plotësojnë kushtet e parapara për tampion si dhe nivelizimi dhe ngjeshja për materialin e bankimit me të dy anët e rrugës në gjerësi (2 x 0.30 cm) dhe rrafshim 4% ngjeshja bëhet me cilindër vrësor deri sa të futeni moduli i ngjeshjes Mv=300 kg/cm <sup>2</sup> . Sigurimi. Pas përfundimit të kësaj shtrëse kompani punëkryese është obliguar të shpërndajë testin moduli të ngjeshjes dhe të prezantojë tek menaxheri kontratës.					
4.2	Furnizimi dhe punimi i shtrësës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-31.5 mm	m <sup>3</sup>	500.00	12.00 €	6,000.00 €
Gjithsej: Post 4					18,350.00
5 PUNIMET E LËSHESAVE (KOMBINAVE) DHE KANALEVE TË HAPJES					
Punimi i lëshesave, pjesëve kaluese dhe kanaleve të mbulueshme në distancë të rrugës sipas detajeve të dhëna në projekt. Në qmim është përfshirë hapja e kanalit dhe vendosja e rrës, furnizimi dhe vendosja e gjatësive, duket duket përfshihen edhe kokalet hyrëse dhe dalëse të lëshesave nga beton armuar sipas detajit teknik të prezantuar në projektilog në m <sup>2</sup> me të gjitha shpenzimet.					
5.1	Lëshes 0-400mm deri 10m gjatësi	m <sup>2</sup>	5.00	10.00 €	50.00 €
5.2	Punimi i kanalit të hapur atmosferik për kullimin e ujërave atmosferik nga skarpate dhe lëshesat me lartësi dhe gjerësi të ndryshueshme konform konfigurimit të terrenit në parashikim në profilin tërthor dhe gjatësor për secilin shpenzim.	m <sup>2</sup>	500.00	0.10 €	50.00 €
Gjithsej: Post 5					100.00
6 PUNIMET E MBISTRUKTURËS ASFALTIT DHE BETONIT					
6.1	Dështimi i kokave të posetave ekzistuese, si dhe ngjeshja dhe punimi i kokave të reja, përfundimi me armaturë, si dhe inkorporimi i ushtrës nivelizimit të kapakut të posetë. Ngjeshja e kokave të posetave bëhet në nivel me kuatosen e asfaltit. Në qmim përfshihen edhe vendosja e kapakut të rrugës DN 000 mm deri 40t llog për copë me të gjitha shpenzimet.	copë	6.00	10.00 €	60.00 €
6.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i asfalt betonit nga materiali i ngjeshës AD16 me trashësi 1-8,0cm, në qmim përfshihen edhe zgjerimi nëpër këmbë Vërejtje: Të miratuar me kontratë në vend dhe të bëhet ATËSTI-METODA MARSHALLI.	m <sup>2</sup>	4000.00	12.00 €	48,000.00 €
Gjithsej: Post 6					48,060.00

**REGAPITULIMI - ASFALTIMI E BRUGËS NË FSHATIN GLLAREVË RIXHEVË STAPANICE ZABERGJE**

1	PUNET PARAPRANE	6,375.00 €
2	PASTRIMI DHE DEMOLIMI TERENIT	375.00 €
3	PUNIMET TOKËSORE	6,025.00 €
4	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONJ)	10,350.00 €
5	PUNIMET E LËSHESAVE (KOMBINAVE) DHE KANALEVE TË HAPJES	100.00 €
6	PUNIMET E MBISTRUKTURËS ASFALTIT DHE BETONIT	48,060.00 €
<b>TOTALI ME TVSH</b>		<b>80,085.00 €</b>



REKAPITULIMI I PËRQËTISHËM I ASFALTIMIT RRUGËVE NË FSHATIN GLLAREVE BUXHIVE STAPANICE ZABERGJE

1	ASFALTIMI I RRUGËS	80,085.00 €
	TOTALI ME TVSH	80,085.00 €

2. PARAMASA PËR NDËRTIMIN E KANALIZIMIT NË FSHATIN GLLAREVE BUXHIVE STAPANICE ZABERGJE

PUNËT PËRGADITORE					
NR.	Përshkrimi i Pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi (€)	Gjithësej (€)
1.1	Shënim i kantiereve me shenja rreziku në zonat ku do të punohet kanalizimi sipas projektit detajlig të kohës së zgjatit punimet. Llog në m'	m'	100.00	0.50 €	50.00 €
1.2	Punet parapërgatitore, shënim gjedezik si dhe verifikimi i trasesë së vjetër të kanalizimit, në matjet gjedezike të përfshihen të gjitha punët e përmendura në kushtet e përgjithshme dhe teknike, po ashtu të maten dilatatet dhe të mundësohet lrynja e kolektorëve të vjetër në kolektorëve e ri, lrynju dhe shkatërimi i gropave, sigjillore ekzistuese në rrjetin e ri të kanalizimit sipas projektit dhe detaleve teknike. Llog në m' Matjet gjedezike në fund të projektit përfshihen të gjitha punët e kryera të sjelljen hartat me kushtet e përgjithshme dhe teknike me gjedret të lincemuar.	m'	100.00	0.50 €	50.00 €
1.3	Pastrimi i terrenit nga mbeturinat, e ngurta ndërtimore, shkurret drunjët e pyllëzuar - në zonat ku do të kalojë traseja e kanalizimit. Pastrimi i tyre bëhet normal me rrjedhën e kanalizimit me grërit 3m për ti mundësuar futjen normale të makinerisë për gërrim si dhe largimin e tyre në deponi, Depoin e caktuar investitorit. Në këtë pozicion përfshihen edhe demolimi i rrethojave dhe këmbëve në gjendje të më parshme pas përfundimit të punimeve. Llog në m'	m'	100.00	0.50 €	50.00 €
1.6	Demolimi i rrjetit ekzistues të vjetër, pastrimi i terrenit dhe krijimi i kushteve ndërtimore për instalimin e rrjetit të ri. Llog në m' me të gjitha shpenzimet	m'	10.00	10.00 €	100.00 €
GJITHËSEJ PUNIMET PËRGADITORE					250.00 €

2. PUNËT E DREJT

2.1	Gërrimi dhe Hapja e kanalit për tokë fushore të kategorisë III-IV në thellësi prej 0.8 m' deri në thellësinë 5.30 m' për kanalizimi fekal dhe gjërësi të nevojshme për punë duke përfshirë të gjitha pikat gjedezike sipas profilit gjatësorë dhe dispozitës së projektit. Pas hapjes së kanalit të ngjeshet me vibrator gjyera e trases së kanalizimit. Vërejtje: Sigurimin nga shembja duhet ta bëjë punëkryesi, sipas detaleve teknike të përfshira në projekt. Squatim : Ky lloj e kategorisë së dheut përfshinë të gjithë zone ku kalon traseja e kanalizimit duke filluar prej Stacionazhes 0.00 deri në përfundim të kanalizimit në stacionazhen e fundit.				
	Punët me makineri (90%)	m3	250.00	0.90 €	225.00 €
	Punët me dorë (10%)	m3	25.00	1.00 €	25.00 €



2.2	<p>gërmimi dhe hapja e dhutë për tokë fushore të kategorisë III-VII duke llogaritur edhe deposti e mbushur me materiale inerto për hapjen e pusetave të kanalizimit në bazë të detajeve, shërbore të përfshirë në projekt.</p> <p>Punët me makinë (90%)</p> <p>Punët me dorë (10%)</p>	m3	16.00	1.00 €	16.00 €
		m3	1.50	1.00 €	1.50 €
2.3	<p>Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së mëm bazës së pusetës nga materiali garar para se të bënihet kineza (hazamenti pusetës), Fraksioti (0 deri 63 ) mm me trashësi të shtresës t=20 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet modulli i ngjeshjes Mv=250 kg/cm2. Materiali i përdorur duhet të jetë i pajtur me ateste paraprake, dhe atë sipas normave dhe standardeve.</p> <p>Vrejtje: Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkyese është e obliguar ta shqyrtojë testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentojë tek menaxheri kontratës.</p>	m3	1.00	5.00	5.00 €
2.4	<p>Furnizimi dhe shtrirja e rrëves 0-1mm, trashësi 10cm për shtratin nën gyp me planifikim ±3cm, dhe 15 cm mbi gyp për mbulimin dhe mbrojtjen e gypit, sipas vërejtjeve dhe përshkrimeve teknike paraprake të specifikuar për punimet tokësore. Gjatë venditje së rrëves të aplikohet glasometria të përcaktuara në bazë të rregulloave dhe standardeve për aplikimin të materialeve ndërtimore në vegjer. Llog. m3</p>	m3	17.50	5.00 €	87.50 €
2.5	<p>Largimi e ujërave nëntokësore të cilët shfaqen gjatë gërmimit të kanalit, të cilët pengojnë currin e punës në instalimin e rrjetit të kanalizimit. Llog me ore/pune me aprovimin e organit mbihqyrtë</p>	ore/pune	5	5.00 €	25.00 €
2.6	<p>Vendosja e trakës mbrojtëse shijshizuese me gjerësi 3 cm përgjatë gjitha trasesë së rrjetit të kanalizimit, për ta identifikuar zonën se ku ndodhet gypat pos mbulimit të kanalit.</p>	m'	100	1.00 €	100.00 €
2.7	<p>Mbushja dhe mbulimi i kanalit pas vendosjes së gypit me sasi të dhutë të përzgjedhur pa gurë me trashësi sipas shërbore dhe detajeve të përcaktuara në projekt për secilin pusetë /stacionet, pastaj vendoset pjesa tjetër e dhutë deri në mbushje përfundimtare të terrenit dhe këllimi në gjendje të mëparshme, dheu i tepër largohet në deponinë më të afërt deri në 15 km largësi.</p>	m3	195.00	1.00 €	195.00 €
<b>GJITHËSHE: PUNIMET E DHUTË</b>					680.00 €
<b>3 PUNËT LATËSE (VENDOSJA E GYPAVE TË KANALIZIMIT)</b>					
3.1	<p>Furnizimi dhe punimi i hazamentit të pusetave prej betoni C- 25/30 të armuar me llastë të armaturore 5-400/500 si dhe punimi i kinetes së pusetave duke i dhënë ranjen e duhur në drejtim të rrjedhës së kolektorit sipas detajit teknik të prezantuar në projekt. Furnizimi dhe montimi i tubave të betonit Ø600 mm nga betoni i parafabrikuar i përpunueshëm nga uji. Kompania ekzekutuese është e obliguar që ta bëjë montimin dhe lidhjen në mes gypave në mënyrë profesionale duke filluar prej montimit të gypit zati kinetë dhe vazhdon me lartësi të ngjashme deri të kupta gjendjeve të përcaktuara në profilin gjatësor të projektit të përfshirë edhe komaset pa kapakë. Lidhja e gypave në mes veti bëhet me llaç cimentoje me raport të recetës 1:3.</p>	copë	2	10.00 €	20.00 €
3.2	<p>Furnizimi dhe vendosja e kapakëve të pusetave nga materiali i beton armuar DN Ø600 mm mos depertimitit e ujërave atmosferike në pusetin e kanalizimit fokal. Sipas detajit të prezantuar në projekt</p>	copë	2	10.00 €	20.00 €





3.3	Vendosja e unazave për nivelizimin e depërimit të gjypit i cili futet në pusetë hartoni me dimensionet sipas projektit, dhe mbështetë në lumen për shkakësimin e kontrolluar të ujit kanalizim të pusetë, unaza në kinez dhe në depërimitin e pusetës duhet përfundohet me llogji dhe raporti 1:1 sipasi status së projektit. Vërejtje : Gjate ekzekutimit të punimeve duhet shuar kujdesë që të ndërmerren të gjitha masa izoluese që parandalojnë rrjedhja para se të futet në pusetë uji fekal dhe mos shkaktohen ndotje ambientale.				
	Unaza DN 250 mm	cone	5	9.00 €	45.00 €
3.4	Furnizimi dhe vendosja e gjypave nga Materiali HDPE kualiteti PSN B, për gjatë gjithë gjatësisë së trases së kanalizimit, duke përfshirë nivelimin dhe përcaktimin e rrafshes në bazë projektit, me të gjitha elementet përcjellëse duke vendosur unaza nga goma ku lidhen gjypat për të parandeluar lëvizjen e gjypave dhe duke pamundësuar hyrjen e gjendëve të ngurta të cilët bllokohen gjypin. Gjate ekzekutimit të projektit të rrespektohen detalet teknike të përfshira në prerjet tërthore dhe gjatesore pa ashtu të rrespektohen kuotat gjendëzike të përfshira projekt. Vërejtje : Punëkryesi pasi të sillin vendosjen dhe instalimin e gjypave duhet të dorëzojë atestet e materialeve konform specifikacionit teknik të projektit				
	GYP HDPE PSN B DN 200 mm	m'	100.00	9.0 €	900.00 €
	GJITHESËJ PUNIMET LATUESE				995.00 €

**REKAPITULIMI - NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË PSHATIN GJAREVE RIXHEVE STAPANICE ZABERGJE**

1	GJITHESËJ PUNIMET PREGADITORE	250.00 €
2	GJITHESËJ PUNIMET E DHEUT	600.00 €
3	GJITHESËJ PUNIMET LATUESE	905.00 €
<b>TOTALI ME TVSH</b>		<b>1,915.00 €</b>

1	<b>Totali i Rrugëve :</b>	<b>80,085.00 €</b>
2	<b>Totali i Kanalizimit :</b>	<b>1,915.00 €</b>
<b>Totali :</b>		<b>82,000.00 €</b>



# KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 634-24-2688-5-2-1/C749

## **Neni 1 Përkufizimet**

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## **Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm**

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## **Neni 3 Transferimi**

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

#### **Neni 4 Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njuh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkritazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

#### **OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES**

##### **Neni 5 Dhënia e dokumenteve**

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

##### **Neni 6 Qasja në vend punishte**

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

##### **Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore**

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejet e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

## **OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT**

### **Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit**

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrin. Ekzekutimi i urdhrin administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

### **Neni 9 Personeli**

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

### **Neni 10 Siguria e ekzekutimit**

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

## **Neni 11           Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit**

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materiale, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrisë çmimin e shpërbllimit nga fitimi i kontraktuesit.

## **Neni 12           Programi**

12.1 Brenda kohës se specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

## **Neni 13           Siguria në vend punishte**

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

